

Arjeta Group SH.P.K me numër unik identifikues 811014282 me adresë në Rr. Salë dhe Hamit Jashari- Skenderaj të cilën e përfaqëson z. Burim Velu – Drejtor i Njësive QTA në njërin anë

Sindikata e Policisë së Kosovës me adresë në Rr. Luan Haradinaj, Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Avni Tahirime Kryetar i Shoqatës Sindikale Regjioni Mitrovicë në anën tjetër. Me datën 01.03.2023 lidhin këtë:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Neni 1.

Kompani Arjeta Group me njësit e saja QTA, deklaron se të gjitha produktet e saja të cilat i ka në njësit e veta do të ofrohen me zbritje prej 3% , për të gjithë anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës regjioni i Mitrovicës

Neni 2.

Zbritja e paraparë me nenin 1 të kësaj marrëveshje do të kalkulohet në arkë në pikat shitëse të QTA.

Neni 3.

Anëtarët e Sindikatës për të përfituar nga kjo zbritje duhet që ti paraqesin arkëtares Kartelën e sindikatës dhe letërnjoftimin, me qellim të evidentimit të zbritjes.

Neni 4.

Në raste kur kompania aplikon zbritje, të produkteve nga çmimi bazë, atëherë zbritja e paraparë me këtë marrëveshje nuk do të zbatohet.

Neni 5.

Kjo marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga të dyja palët, dhe është valide deri në revokimin e sajë.

Secila Palë merr nga një kopje identike.

Arjeta Group
Njësit QTA



Avni Tahiri Kryetar
i Shoqatës Sindikale të Policisë në DPR

